



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË

Numri i lëndës: 2023:225279

Datë: 20.05.2024

Numri i dokumentit: 05704942

C.nr. 558/2023

Gjykata Themelore Gjilan - Dega në Kamenicë, Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil, përmes gjyqtarës Valbonë Dërvodeli, me bashkëpunëtorin profesional Irfan Thaqi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.D. nga, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Selmon Sadiku, avokat nga Kamenica, kundër të paditurës Komuna e Kamenicës-Drejtoria e Arsimit, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Alban Hashani, jurist nga Kamenica, me objekt kontesti kompensimin e shujtës ditore, udhëtimit dhe kualifikimit, jashtë seancës, më datë 20.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. Aprovohet në tërësi si e bazuar në ligj kërkesëpadia e paditësit A. D. nga, dhe Detyrohet e paditura Komuna e Kamenicës, që paditësit në emër të kompenzimit të shpenzimeve për ushqim (shujtës ditore), për 404 ditë pune, edhe atë për periudhën kohore prej datës 14.09.2020, e deri më datën 22.11.2022, t'ia paguaj shumën prej 808.00 euro, në emër të shpenzimeve të udhëtimit, shumën prej 565.00 euro, në emër të kompensimit të diferencës në pagë për kualifikim shkollor – fakultet, në lartësi 27 % të pagës bazë për prej datës 19.10.2020 deri më datë 06.02.2023 edhe atë për 28 muaj, shumën nga 60.25 € për çdo muaj, këto në shumë prej 1,687.00 €, e në shumë të përgjithshme të hollave prej **3,060.00 euro**, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e ushtrimit të padisë, të gjitha këto në afat prej 7 ditë, pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit ligjor.

II. Detyrohet e paditura, që paditësit t'ia paguajë shpenzimet e procedurës kontestimore, në shumë të përgjithshme prej 144.00 euro, në afat prej 7 ditë, pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit ligjor.

A r s y e t i m i

Paditësi, përmes të autorizuarit të tij, më datë 20.10.2023, në këtë gjykatë, ka paraqitur padi kundër të paditues Komuna e Kamenicës - Drejtoria Komunale e Arsimit, për kompensimin e shujtës ditore, udhëtimit dhe kualifikimit, me vlerë të kontestit 3,155.00 euro. Në padi ka theksuar se paditësi është në marrëdhënie pune në Gjymnazin "Ismail Qemali", në Kamenicë, në pozitën e mësimitdhënësit. Baza ligjore lidhur me këtë kërkesë ka theksuar se gjendet në

Kontratën Kolektive të Arsimit, neni 35, paragrafi 5, 7 dhe Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, Nr.01/33 i datës 29.08.2008.

Përfaqësuesi i paditësit, përmes parashtrësës për precizimin e kërkesëpadisë të datës 02.05.2024, ka kërkuar nga gjykata që të detyrohet e paditura që paditësit për kompensimin e shujtës ditore për 404 ditë pune tia paguaj shumën prej 808.00 euro, për shpenzimet e udhëtimit shumën prej 565.00 euro, për kualifikim master në artësi 27% të pagës bazë për 28 muaj shumën prej 1,687.00 euro, e në shumë të përgjithshme të hollave prej 3,060.00 euro. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar edhe atë 104 euro për përpilimin e padisë si dhe shumën prej 40 euro për taksën gjyqësore.

Gjykata konform nenit 394, 395 dhe 396 të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore (në vijim: LPK-së) të paditurës i ka dërguar aktvendimin për përgjigje në padi, së bashku me padinë dhe provat e bashkëngjitura padisë për tu deklaruar me shkrim në padinë e paditëses.

E paditura, me anë të përgjigjes në padi, e ka kundërshtuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses pasi që kontratën të cilën e bazon paditësi nuk prodhon efekte juridike dhe nuk krijon të drejta dhe detyrime ndaj Komunës së Kamenicës, si e paditur, meqë e njëjta nuk është e regjistruar në MPMS-ës, si dhe është paraparë së bashkërisht MASHT-I dhe SBASHKU dhe Ministria e Financave angazhohen bashkërisht që të bëjnë sigurimin e mjeteve. Për më tepër ka theksuar se e paditura nuk ka marrë obligim përmbushjen e obligimeve që rrjedhin nga kontrata e lartëcekur e nga këto nuk ka legjitimitet real pasiv.

Gjykata, pas pranimit të përgjigjes në padi, ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara në nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së) për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës, sepse në mes të palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, pasi që nga përgjigja në padi rezulton qartas se padia e paditësit është tërësisht e bazuar.

Gjykata, ka gjetur se mes palëve nuk janë kontestuese faktet se paditësja është e punësuar pranë të paditurës, as paga bazë apo kompensimet e shtesave, por kontestues është fakti se a ka bazë ligjore për kompensim e shujtës ditore, udhëtimit dhe kualifikimit-licencimit për paditësin. Nuk është kontestuese se paditësi është i kualifikuar me fakultet dhe e licencuar (fakt ky i bazuar nga diploma nr.1368, e dt.21.03.2012 dhe licenca e mësdhenëses nr.100002129) dhe se i njëjti nga dt.14.09.2020 deri më dt.22.11.2022, ka qenë në punë për 404 ditë (fakt ky i vërtetuar nga vërtetimi nr.215, i datës 26.04.2024, i lëshuar nga kjo shkollë), dhe se i njëjta pagën bazë e ka në shumë prej 459.00 euro (fakt i vërtetuar nga lista e pagave të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës).

Gjykata, para se të vendos në mënyrë meritorë në këtë çështje kontestimore i ka vlerësuar kushtet ligjore nga neni 398 i LPK-së, me të cilin përcaktohet se “*kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta japë aktgjykimin me të cilin e pranon si të themeltë kërkesëpadinë*”, dhe ka konstatuar se ekzistojnë kushtet ligjore për marrjen e këtij Aktgjykimi, pasi që faktet

vendimtare nuk janë kontestuar nga ana e të paditurës, respektivisht nuk është kontestuar gjendja faktike, se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura.

Andaj, gjykata në këtë çështje kontestimore sa i përket të drejtave subjektive të paditësit dhe lartësisë së saj, ka zbatuar dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, të datës 18.04.2017 dhe KKAK-së të datës 22.01.2021, konkretisht nenin 35 parag.5, 7 të kësaj kontrate, si dhe Mendimit juridik me nr.prot.214/2023, të datës 09.10.2023, të Gjykatës Supreme të Kosovës, ndërsa procedura është zhvilluar në bazë të Ligjit të Procedurës Kontestimore në fuqi.

Gjykata me rastin aprovimit të kërkesëpadiisë, pati parasyshtë dispozitën ligjore të nenit 35, parag. 7 të Kontratave Kolektive të Arsimit, ku është përcaktuar se *“Të punësuarve, u sigurohen kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë për një ditë pune është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arismore. Punëdhënësi i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve përmes restorantit a kuzhinës ose në një formë tjetër nuk ka obligim kompensimin për ushqim”*, në rastin konkret institucionet shkollore nuk e kanë të rregulluar ushqimin përmes restoranteve apo kuzhinave, andaj, e obligoj të paditurën që paditësit t’ia kompensoj për 404 ditë pune, shumën prej 808.00 euro, në emër të ushqimit për ditë e pranisë në punë, nga data 14.09.2020 deri më datë 22.11.2022. euro. Ndërsa në Vendimin e Qeverisë, Nr.01/33 të datës 29.08.2008, i cili vendim ka qenë në fuqi deri më datë 06.02.2023 (i shfuqizuar me Ligjin për Pagat në Sektorin Publik, Nr.08/L-196), është përcaktuar se të gjithë mësimdhënësit do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit, pra mësimdhënësve, drejtorëve, zëvendës drejtorëve dhe bashkëpunorëve profesional, përfitojnë rritje page me diplomë të shkollës normale 10 % të pagës bazë, me diplomë të shkollës pedagogjike me nje ngritje te pagës bazë prej 19%, me diplome universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27% dhe me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35 %.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar dhe duke pas parasyshtë provat materiale në shkresat e lëndës në këtë çështje kontestimore, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadiia e paditësit është e bazuar dhe të njëjtën e ka aprovuar sikurse në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi që nga provat e administruara ka vërtetuar faktin se paditësi është në marrëdhënie pune te e paditura, punonë si mësimdhënë, dhe nga data 14.09.2020 deri më datë 22.11.2022, ka qenë në punë për 404 ditë.

Ndërsa sa i përket shpenzimeve të udhëtimit për paditësin për 404 ditë punë, në lartësi 70% të biletës së udhëtimit, në shumë prej nga 565.00 euro, gjykata mori parasyshtë dispozitën e nenit 35 parag.5 të KKAK, ngase paditësi jeton ne fshatin Shipashnicë e Epërme, Komuna e Kamenicës (fakt i bazuar nga certifikata e vendbanimit, në emër të paditësit), ndërsa sa i përket lartësisë së kompensimit gjykata pati parasyshtë dy koponat fiskal të lëshuar nga “Perparimi 90” sh.p.k çmimin i biletës së udhëtimit për dy drejtime nga fshati Shipashnicë e Epërme, për në Kamenicë, është 2 euro.

Ndërsa në Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, Nr.01/33 i datës 29.08.2008, është përcaktuar shprehimisht në pikën 4 se, *Mësimdhënësve me diplomë fakulteti tri dhe katër vjeçar 27 % të pagës bazë*, qka paditësi në rastin konkret është e kualifikuar me pregaditje shkollore fakultet, ndërsa sa i përketë lartësisë së kompensimit gjykata pati parasysh pagën bazë të paditësit, në shumë prej 459.00 euro, këtë sipas listës së pagave në emër të paditësit.

Zbatimi i këtij vendimi të Qeverisë, rastet e kualifikimit-licencimit është në përputhje edhe me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr. 214/2023 të datës 05.10.2023.

Në rastin konkret, gjykata vlerësoi se e paditura nuk ia ka kompensuar paditësit pagën sipas përqindjes për shkak të kualifikimit shkollor, përkatësisht me kualifikim- Fakultet, paditësi është paguar në shumën prej nga 63.68 euro për kualifikim, ndërsa sipas përqindjes së përcaktuar në Vendimin e Qeverisë, është dashur të paguhet për 27 % të pagës bazë, shumën prej nga 60.25 euro, sipas pagës bazë prej 459.00 euro,

Gjykata, vlerëson se pretendimet e të paditurës të parashtruar me përgjigjen në padi se KKAK-së nuk është regjistruar në MPMS-së, ashtu siq kërkohet me Udhëzimin Administrativnr.12/2021, për regjistrimin e Marrëveshjeve Kolektive, nga ky fakt nuk prodhon efekt juridik, me tutje ka shtuar se nuk ka buxhet për zbatimin e kësaj kontrate, si dhe në bazë të nenit 12 parag.1 të Udhëzimit Administrativ nr.5/2017, sistemi i licencimit dhe zvellimit të mësimdhënësve ne karrierë, shihet se mesimdhënësit janë me licenca të skaduara, duke përfshirë edhe kundërshtimet tjera të cekura në përgjigjen në padi, gjykata vlerëson se këto pretendime janë të pabazuara dhe të paqëndrueshme, pasi që KKAK është lidhur në nivel vendi sipas dispozitave të nenit 90 Ligjit të Punës, çka nënkupton se meqë KKAK është e lidhur në nivel vendi, e njejta prodhon efekt juridik edhe ndaj komunës së Kamenicës, këtu të paditurës. Pos kësaj, edhe me nenin 2 parag.1 pika 1.1 të KKAK-së, në mënyrë shprehimore është paraparë se: “Dispozitat e kësaj kontrate janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet e Arsimit Parauniversitar.....”, ndërsa me pikën 1.2 të po këtij neni, është cektur se: “Dispozitat e kësaj Kontrate janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e arsimit (Komunat-DKA, KD të Universiteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj)...”. Në interpretim të kësaj dispozite, gjykata vlerëson se e paditura ka përgjegjësi në përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara nga KKAK, pasi që me këtë dispozitë është cekur qartë se të punësuarit por edhe punëdhënësit janë të detyruar t’i zbatojnë dispozitat e kësaj kontrate, andaj edhe të njejtët janë përgjegjëse në përmbushjen e detyrimeve të cilat dalin nga KKAK-së.

Gjykata për kamatën ligjore prej 8% ka vendosur duke u bazuar në dispozitën e nenit 382 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Gjykata duke patur parasysh suksesin në procedurë të paditëses dhe duke u bazuar në nenin 449, 452 dhe 463, parag. 1 të LPK-së dhe nr. tarifor 6 dhe 7 të Rregullores për Tarifat e Avokatëve, të datës 18.03.2017, ka aprovuar pjesërisht kërkesën për shpenzimet e kërkuara nga i autorizuari i paditësit, ashtu që e ka detyruar të paditurën që paditësit t’ia paguaj shpenzimet e procedurës, edhe atë: për përpilimin e padisë, shumën prej 104.00 euro, dhe për taksë gjyqësore, shumën prej 40.00 euro, e në shumën e përgjithshme prej 144.00 euro.

Gjykata, nga të lartëcekurat e bazuar në nenin 143, paragrafi 1 lidhur me nenin 398 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata Themelore Gjilan - Dega në Kamenicë
Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil
C.nr.558/2023, më datë 20.05.2024

Gjyqtarja,
Valbonë Dërvodeli, d.v

Udhëzim Juridik: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në afat prej 7 ditë, pas ditës së pranimit të të njëjtit. Ankesa dorëzohet në dy ekzemplar përmes kësaj gjykate.